

MASTER PROFESIONAL NË “MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”	
Statusi i akreditimi të programit të studimit	AKREDITUAR me vendim nr. 27, datë 07.02.2025	
Cikli i studimit	Program i ciklit të dytë të studimit	
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Institucion Publik i Akredituar	
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip	
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite	
Forma e studimit	Me kohë të plotë	
Kushtet e pranimit	1. Pranimi i studentëve në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, i cili jep akses në programet e ciklit të dytë të studimeve, në fushën e mësuesisë. 2. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: (<i>anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht</i>), në nivelin B₁, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.	
	Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”	a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “Bachelor” në Mësues i Arsimit Fillor dhe “Bachelor” në Mësues i Arsimit Parashkollor. b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.
	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.
	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “Bachelor”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.

- | | |
|--|--|
| | <p>3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës mesatare të ciklit të parë “Bachelor”, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia bazë, atëherë kandidatët do të seleksionohen sipas:</p> <ul style="list-style-type: none">a. Nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor” për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në Mësues në Arsimin Special.b. Notës mesatare në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”. |
|--|--|

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit 2-vjeçar të studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special” është të aftësojë studentët në ofrimin dhe thellimin në mënyrë më specifike dhe inovatore të njohurive teorike dhe praktike në fushën e edukimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi ndryshe/nevojatë veçanta/vështirësi në të në formimin e tyre të përgjithshëm. Programi është riorganizuar e zhvilluar në mënyrë të tillë, që të mundësojë zhvillimin e aftësive, shprehjeve dhe kompetencave për çështje të ndryshme dhe të pashkelura në institucionet e arsimit parauniversitar si dhe në qendrat e edukimit të trajtimit special. Programi gjithashtu ofron dije të avancuara në fushën e kërkimit shkencor, duke i aftësuar studentët të njohin, kuptojnë dhe integrojnë në punën e tyre, gjetjet e studimeve bashkëkohore në këtë fushë, të ndërmarrin studime aktuale në kontekstin shqiptar dhe të transmetojnë këto gjetje në punën e tyre në grupet e interesuara.

Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:

1. **Të zotërojnë njohuri të avancuara** mbi teoritë dhe praktikën në fushën e arsimit special, përfshirë zhvillimin dhe të nxëniet e fëmijëve me nevojatë veçanta.
2. **Të jenë të aftë të identifikojnë**, vlerësojnë dhe të punojnë në mënyrë profesionale me fëmijë që kanë nevojatë veçanta arsimore;
3. **Të zhvillojnë aftësi për të planifikuar, realizuar dhe vlerësuar** procesin mësimor për fëmijët me çrregullime të ndryshme (fizike, mendore, emocionale ose sociale).
4. **Të promovojnë përfshirjen sociale dhe arsimore** të fëmijëve me nevojatë veçanta në sistemin arsimor të zakonshëm.
5. **Të dizajnojnë dhe zbatojnë programe individuale mësimore (PIM)** të përshtatura për secilin nxënës.
6. **Të përdorin strategji efektive të menaxhimit të sjelljes** dhe ndërhyrje edukative sipas tipologjisë së nevojës speciale.
7. **Të vlerësojnë dhe monitorojnë progresin** mësimor dhe social të nxënësve me ndihmën e mjeteve të specializuara.
8. **Të punojnë në mënyrë ndërdisiplinore** me psikologë, logopedë, prindër dhe aktorë të tjerë të përfshirë në zhvillimin e fëmijës.
9. **Të ndërtojnë mjedise mësimore gjithëpërfshirëse** dhe të aksesueshme për të gjithë nxënësit.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është, aftësia e Mësuesit të Edukimit Special, për të: identifikuar, mbështetur dhe ndërhyrë në mënyrë profesionale në procesin edukativ të fëmijëve me nevojatë veçanta arsimore.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi praktike, diagnostikuese, terapeutike dhe komunikimi ndërdisiplinor, që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin arsimor dhe komunitar, në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të: psikopedagogjisë, terapisë zhvillimore, logopedi, metodologjisë së mësimdhënies së diferencuar, Terapisë së artit dhe lojës, Terapisë nëpërmjet muzikës, Terapisë nëpërmjet edukimit fizik si dhe në fushën e Teknologjisë së informacionit dhe komunikimi në edukimet.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm:**Motivimi dhe produktiviteti, Psikologjizhvillimi e avancuar **Kredite (12 ECTS)**
2. **Lëndë të formimit karakterizues:**Logopedia, Çrregullime dhe terapi e të folurit, Strategji didaktike në edukimin special, Mësimdhënia e diferencuar në edukimin special, Vështirësi në të nxënë-Disleksia, Komunikimi në edukimin special, Metodat psikodiagnostikuese në edukimin special, Terapi profesionale për fëmijë dhe adoleshente. **Kredite(50ECTS)**
3. **Lëndë integruese:** Gjithëpërfshirja në edukimin, Sociologji në edukim, Zhvillim kurrikule, Edukim qytetar.Lëndë me zgjedhje:Terapi arti dhe loje, Terapi nëpërmjet muzikës, Lëndë me zgjedhje:Metodat e kërkimit në edukimin special, Terapia nëpërmjetedukimit fizik. **Kredite (34 ECTS)**
4. **Lëndë të formimit plotësues:** Teknologjia e informacionit dhe komunikimi në edukim,Praktikë Profesionale. **Kredite (12ECTS)**
5. **Detyrime përmbyllëse:**Provimi i përgjithshëm përfundimtar / punim diplome**Kredite(12 ECTS)**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm: 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75– 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95– 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit dyte te studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arsimin Special” është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonëbashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë në fushat e veprimtarisë profesionale si dhe thellimin e

mëtejshëm të teorive dhe praktikave të punës, si dhe specialitete të veçanta për trajtimin e fëmijëve me aftësiindryshe, me grupe të larmishme nxënësish dhe me nevoja specifike mbështetëse. Studenti i cili diplomohet në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arsimin Special” mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në të njëjtën fushë, apo në një fushë të ngjajshme. Si Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia Bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programet. Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë / mësues të arsimit special në fushën / fushatë psikologjise dhe pedagogjisë speciale, të kualifikuar me njohuri të tilla si: vlerësimi dhe trajtimi i nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, krijimi i planeve individuale të mësimin, përdorimi i metodave dhe strategjive të diferencuara të mësimdhënies, si dhe mbështetje psikologjike dhe emocionuese për nxënësit me nevoja speciale. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në Arsimin Special” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen si :

1. Mësues ndihmës në institucionet e arsimit parauniversitar apo në qendrat të specializuara për fëmijë me vështirësi në të nxënë/aftësi ndryshe/nevoja të veçanta
2. Drejtues , mësues, specialist në administratën arsimore në fushën e arsimit
3. Institucione kërkimore që merren me çështje të edukimit
4. Qendra ditore dhe ato rezidenciale si terapist zhvillimi
5. Institucione shëndetësore dhe klinika psiko-sociale.
6. Qendra zhvillimi duke qenë pjesëtarë i ekipeve multidisiplinare për vlerësimin dhe ofrimin e terapive mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta.
7. Shërbime këshillimi dhe terapi për individë me aftësi të veçanta.
8. Organizata joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave të personave me nevoja speciale
9. Projekte dhe programe ndërkombëtare që mbështesin arsimin gjithëpërfshirës dhe zhvillimin e personave me aftësi të veçanta.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit Master Profesional në “Mësues në Arsimin Special”, fitojnë njohuri në metodat dhe teknikat e avancuara të mësimdhënies për individë me nevoja të veçanta, si dhe aftësi për të zhvilluar dhe implementuar plane individuale të mësimin (PIM), duke përdorur qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura për nevojat e ndryshme të nxënësve. Ata gjithashtu fitojnë njohuri të thelluara në psikologjinë e zhvillimit dhe diagnozën e aftësive të veçanta, në mënyrë që të krijojnë mjedise edukative të sigurta, mbështetëse dhe stimuluese për të gjithë nxënësit. të diplomuarit do të specializohen për të kuptuar karakteristikat e veçanta të individëve duke ju qasur atyre në mënyrë shkencore dhe holistike. Roli i mësuesit ndihmës tashmë merrnjë rëndësi të veçantë për të gjitha vendet e civilizuara dhe në mënyrë specifike edhe në sistemin tone arsimor, i cili shfaq mangësi dhe nuk i përgjigjet cilësisht nevojave të fëmijëve me aftësiindryshe/nevojatëveçanta/ vështirësi në të nxënë.

Përveç kësaj, ata do të zhvillojnë aftësi për të menaxhuar klasat dhe për të përdorur teknologji të avancuara edukative, si dhe për të bashkëpunuar me specialistë të tjerë (psikologë, terapistë, punonjës socialë) për të siguruar mbështetje të plotë për nxënësit me nevoja speciale.

Këto njohuri dhe aftësi i ndihmojnë studentët të jenë profesionistë të kualifikuar dhe të gatshëm për të trajtuar sfidat e ndryshme që mund të lindin në mjediset e arsimit special.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Motivimi dhe produktiviteti	6	150	1
2.	Logopedia	6	150	1
3.	Çrregullime dhe terapi e të folurit	6	150	1
4.	Strategji didaktike në edukimin special	6	150	2
5.	Mësimdhënia e diferencuar në edukimin special	6	150	2
6.	Vështirësi në të nxënë-Disleksia	6	150	1
7.	Gjithëpërfshirja në edukimin	6	150	1
8.	Sociologji në edukim	6	150	2
9.	Zhvillim kurrikule	6	150	2
Lëndë me zgjedhje				
10.	1. Terapi arti dhe loje 2. Terapi nëpërmjet muzikës	6	150	2
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Psikologjizhvillimi e avancuar	6	150	1
2.	Komunikimi në edukimin special	6	150	2
3.	Metodat psikodiagnostikuese në edukimin special	7	175	1
4.	Terapi profesionale për fëmijë dhe adoleshentë	7	175	1
5.	Edukim qytetar	6	150	2
6.	Teknologjia e informacionit dhe komunikimi në edukim	4	100	2
7.	Praktikë Profesionale	8	200	1+2
Lëndë me zgjedhje				
7.	1. Metodat e kërkimit në edukimin special	2	50	1
	2. Terapia nëpërmjet edukimit fizik	2	50	1
9.	Provim i përgjithshëm përfundimtar /punim diplome	12	300	2
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500 orë	
Total : viti I + viti II		120 ECTS	3000 orë	